



DERAND

HOTEL

KONKURS

Nëse dëshironi të realizoni ëndrrën tuaj, ku mund të i tregoni aftësitë dhe shkathtësitë e juaja personale, të punoni në një ambient të ngrohtë dhe dinamik, atëherë tani është rasti i juaj. Në qendër të Prishtinës, në lagjen Lakrishte, Rr. Tirana, do të hapet DERAND Hotel.

Me qëllim të plotësimit të vendeve të lira të punës DERAND Hotel kërkon staf të kualifikuar dhe profesional për pozita të caktuara. Ajo çka kërkojmë ne është të jeni të përgatitur profesionalisht, të jeni të përgatitur për sfidat e gastronomisë, të keni paraqitje miqësore, të njihni kërkesat e hotelerisë, të keni entuziazëm, profesionalizëm dhe të silleni me respekt.

Ne ofrojmë punësim me kontratë afatgjate, ambient komod dhe të rehatshëm si dhe pagë joshëse.

Pozitat vijuese ku mund të aplikoni janë:

▪ Punëtor i sigurimit

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Përgjegjës për shikimin dhe kontrollimin e të gjitha hyrje - daljeve të hotelit dhe për rreth tij;
- Përgjegjës për ruajtjen e rregullit dhe të qetësisë në hotel si dhe ndalon qasjen e personave të panjohur në ato pjesë të hotelit, ku nuk lejohet qasja e tyre apo ku kërkohet privatësi;
- Përgjegjës për të parandaluar të gjithë personat të cilët provojnë të kryejnë ndonjë delikt apo vepër penale brenda ambientit të hotelit;
- Përgjegjës për të monitoruar gjatë tërë kohës, kamerat lëvizëse të sigurisë, sistemet e alarmit dhe pajisjet e tjera elektronike të mbikëqyrjes;
- Përkujdeset që gjatë natës klientët/mysafirët e hotelit të flenë të lirë, në qetësi dhe pa shqetësime;
- Përkujdeset për shikimin dhe kontrollimin e hyrje - daljeve të njerëzve, ngarkim dhe shkarkimin e mallrave dhe të pajisjeve si dhe lëvizjen e automjeteve;
- Përkujdeset për të lejuar hyrjen në ambientet e punës dhe në ambientet e tjera të hotelit, vetëm të personave të autorizuar dhe të atyre që iu kanë nënshtruar procedurave të kontrollit;
- Përkujdeset për të penguar dhe ndaluar sabotimet dhe diversionet e mundshme;
- Përkujdeset që gjatë tërë kohës të patrollojë në të gjitha hapësirat e hotelit si dhe jashtë, duke komunikuar nëpërmjet radio-lidhjeve për çdo lëvizje të dyshimtë;
- Përkujdeset për mbrojtjen e mysafirëve, pasurisë dhe të personave të tjerë dhe të punësuar në hotel;
- Përkujdeset që në rast të shpërthimit të zjarrit, të ndërmerë masa për shuarjen dhe lajmërimin e tij;
- Përkujdeset që në librin e posaçëm të mbajë evidencë për hyrje - daljet e dyshuara dhe të bëjë vërtetimin e identitetit të atyre personave, duke marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me shërbimin e sigurisë dhe të mbrojtjes së objektit;

Kualifikimet dhe aftësitë profesionale

- Minimum arsimit i mesëm;
- Shkathtësi të njohjes së punës në sigurime të objekteve dhe të njerëzve;
- Shkathtësi të menaxhimit të punës nën presion;
- Të ketë së paku 3 (tri) vite përvojë pune në sigurim të objekteve;
- Certifikata për kryerjen e trajnimeve profesionale në sigurimin fizik të objekteve;

▪ Axhustator/teknik i sistemeve të makinerisë

Detyrat dhe përgjegjësitë



- Është i obliguar që t'i kryejë punët në kohë dhe kualitet të lartë në përputhje me rregullat dhe udhëzimet teknike;
- Vëzhgon pajisjet mekanike në operim për të gjetur shkaqet e problemeve;
- Demonton pajisjet për të pasur mundësinë e heqjes së pjesëve të dëmtuara dhe riparon ose zëvendëson pjesët e dëmtuara;
- Kryen mirëmbajtjen preventive – bënë kontrollim të rregullt të pajisjeve makinerike sipas planit të aprovuar nga udhëheqësi;
- Monitoron cilësinë e punës në të gjitha fazat e saldimit, duke bërë kontrole dimensionale dhe vizuale dhe duke bërë teste;
- Përkujdeset për mirëmbajtjen e sistemeve të makinerisë, nxemjeve, ventilimit;
- Përkujdeset për mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit;
- Vlerëson pajisjet, strukturat, materialet dhe specifikimet e punës për pozicionet dhe metodat e duhura të saldimit;
- Gjatë realizimit të punëve duhet të kujdeset për sigurimin e vendit të punës, të jetë i përgaditur me mjete dhe vegla të punës ashtu që puna të kryhet me sukses në çdo aspekt;
- Sipas nevojës kryen edhe detyra tjera shtesë sipas kërkesës së udhëheqësit.

Kualifikimet dhe aftësitë profesionale

- Diploma e shkollës së mesme ose kualifikimi ekuivalent;
- Përvojë pune 2 vjeçare;
- Njohuri për punën profesionale;
- Aftësi të mira komunikuese, ndërpersonale dhe organizative;
- Aftësi për t'u përshtatur në punën në grup;
- Aftësi për të lexuar dhe interpretuar skemat përkatëse.

Për të aplikuar në njërin nga pozitat e lira, ju lutem dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera përcjellëse, duke e përmendur në "Subject" pozitën për të cilën aplikoni. Aplikimi të dërgohet në këtë e-mail: a.vranica@derandhotel.com dhe për sqarime shtesë përmes tel: +383 (49) 987 600

Ju lutem keni parasysh se vetëm kandidatët që kanë kaluar me sukses përzgjedhjen fillestare do të marrin përgjigje pozitive dhe do të ftohen në intervistë.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga data e publikimit.